


Mbas shkollimit të detyrueshëm

Arsimimi profesional dhe shkollat e mesme

Pas shkollimit të detyrueshëm vajzave të reja dhe djemve të rinj u qëndrojnë hapur mundësitë e shumëllojshme arsimore.



© Grafik: SBF

Shkollime profesionale (Berufsausbildungen)

Shkollimet profesionale bazë (mësim zanatesh)(Berufslehren) janë kualifikime të rregulluara me kontratë, tek të cilat periudha mësimore dhe programi kualifikues janë gjithashtu të rregulluara. Ndërmjet nxënësve dhe mësimdhënësve lidhet një marrëveshje mësimore. Autoritetet kantonale e miratojnë kontratën mësimore.

Pjesa shkollore përbëhet nga arsimimi shkollor i përgjithshëm dhe nga mësimi i profesionit dhe mundësohet nga shkollat profesionale (Berufsfachschulen).

Si plotësim nxënësit frekuentojnë kurse për ndërmarrjet që ofrohen dhe udhëhiqen nga shoqata profesionale të kësaj fushe.

Arsimimi profesional bazë (berufliche Grundbildung) zgjat dy deri në katër vjet.

Arsimimet profesionale bazë përfundojnë me procedurën kualifikuese (provimin përfundimtar mësimor/ Lehrabschlussprüfung). Arsimimet bazë tre- deri në katër vjeçare çojnë te një dëftesë aftësie zvicerane (eidgenössischen Fähigkeitszeugnis), dy vjeçaret në një vërtetim profesioni zviceran (eidgenössischen Berufsattest). Dëftesa zvicerane e aftësisë çon së bashku me përfundimin e më tejshëm të një arsimimi të përgjithshëm (maturë profesionale/Berufsmaturität), në certifikatën zvicerane të maturës profesionale.

Viti përgatitor profesional

Viti përgatitor profesional (Berufsvorbereitungsjahr) dhe paramësimi (Vorlehre) zgjasin një vit. Ata i përgatisin të rinjtë në mënyrë praktike dhe shkollore për arsimimin profesional. Të rinjtë mund të zgjedhin ndërmjet ofertave shkollore (5 ditë në shkollë), ofertave praktike (3 deri 4 ditë në shkollë, 1 deri 2 ditë në punishten e vetë shkollës) ose ofertave të ndërmarrjes përkatësisht paramësimi (1 deri 2 ditë në shkollë, 3 deri 4 ditë në ndërmarrjen për praktikë). Një vit orientimi integruar përgatitor profesional u drejtohet personave të huaj të moshës 15 deri në 21 vjeç. Fokus kryesor këtu është mësimi i gjermanishtes dhe përkrahja për zgjedhjen e profesionit.

Matura profesionale

Matura profesionale përbëhet nga arsimimi profesional bazë i kryer (mësim zanati) dhe nga një arsimit i përgjithshëm i zgjeruar, i cili jepet në shkollën e maturës profesionale (BMS).

Mësimi i maturës profesionale përfshin lëndë gjuhësore, lëndë shoqërore, matematikë, si dhe sipas drejtimit në financë- dhe kontabilitet, shkencave të natyrës, shkenca shoqërore ose lëndëve të artit-dhe krijimtarisë. I gjithë mësimi shoqëruar zgjat mesatarisht dy ditë në javë.

Certifikatën e maturës profesionale e merr ai i cili e ka kaluar me sukses procedurën e kualifikimit të arsimimit bazë si dhe e ka dhënë provimin e maturës profesionale. Zotërueset dhe zotëruesit e certifikatës së maturës profesionale fitojnë një kualifikim të dyfishtë: ata kanë një kompetencë profesionale dhe një kualifikim për vazhdim (pranim) në një shkollë të lartë pa dhënien e ndonjë provimi. Për këtë matura profesionale është një bazë e shkëlqyer për një kualifikim të mëtejshëm profesional.

Qendra për njoftim- dhe informim për shkollime profesionale

Mësuesit e ciklit të dytë (Sekundarstufe) të shkollës fillore i përkrahin të rinjtë në përgatitjen për zgjedhjen e profesionit dhe janë edhe persona të rëndësishëm ku edhe prindërit mund tju drejtohen për informim. Informacione të hollësishme ofrojnë konsultat për zgjedhjen e mjeshtërisë.

Disa adresa që informojnë hollësisht:

Amt für Jugend und Berufsberatung
Zentralstelle für Berufs- und Studienberatung
Dörflistrasse 120
8090 Zürich
www.berufsberatung.zh.ch

Das Mittelschul- und Berufsbildungsamt
der Bildungsdirektion Kanton Zürich
Ausstellungsstrasse 80
8090 Zürich
www.mba.zh.ch

Zentralstelle für Berufsberatung
Lehrstellennachweis des Kantons Zürich
www.lena.zh.ch
Online-Verzeichnis der offenen Lehrstellen

Shkollat e mesme

Shkolla e mesme (Mittelschule)

Vitet shkollore të gjimnazeve të Cyrihut bazohen në rregulloren zvicerane për njohjen e maturës (MAR) dhe prin në një certifikatë të pranuar zvicerane të maturës. Certifikata e maturës u jep të drejtën për hyrje në të gjitha shkollat e larta universitare të Zvicrës. Një provim pranues shtesë është kusht për pranimin në një studim të mjekësisë. Mësimi në gjimnaz jepet në një nivel me kërkesa të larta profesionale nga mësues të kualifikuar shkencorë. Gjimnazi me kohëzgjatje të shkurtër (Kurzgymnasium) u qëndron hapur nxënësve të talentuar dhe këmbëngulës për sukses të ciklit të dytë dhe nxënësve pas klasës së dytë ose të tretë të ciklit të dytë të grupit A (dhe nga viti 2015 edhe grupi B), të cilët frekuentojnë mësimin në nivelet me pretendime të larta ose të mesme.

Kush dëshiron të frekuentojë një shkollë të mesme duhet të zgjedhë një profil të maturës:

- Profili i gjuhëve të vjetra (A) me latinishten dhe/ose greqishten pranë gjuhëve të huaja moderne, njëra nga gjuhët e vjetra është lënda kryesore.
- Profili i gjuhëve të reja (N) me gjuhët e huaja moderne, njëra nga këta si lëndë kryesore
- Profili i shkencave matematiko-natyrore (MN) me «biologjinë dhe kiminë» ose «fizikë dhe zbatimet e matematikës» si lëndë kryesore
- Profili ekonomiko-juridik (WR) me lëndën kryesore «ekonomi dhe drejtësi»
- Profili i muzikës (M) me «krijimet pikturore» ose «muzikën» si lëndë kryesore

Një kurs mature dygjuhësor (gjermanisht/anglisht, gjermanisht/frëngjisht ose gjermanisht/italisht) mund të frekuentohet në 18 gjimnazet e Cyrihut. Aftësive të veçanta u jepet prioritet në gjimnazin e artit- dhe sportit në MNG Rämibühl si dhe në Liceo Artistico. Si gjimnaze të shkurta pesëvjeçare, këto shkolla mbështesin talentet e artit dhe të sportit dhe çojnë njëkohësisht në maturën e pranuar zvicerane, kurse Liceo Artistico veç kësaj në maturën italiane.

Paleta e mundësive arsimore plotësohet nëpërmjet diplomës ndërkombëtare (International Baccalaureate (IB)), e cila merret në lidhje me maturën zvicerane si dhe nëpërmjet shkollave të mesme profesionale tre- ose katërvjeçar që vijnë prej ciklit të dytë të shkollës fillore dhe që çojnë në një shkollë të lartë ose në një shkollë të lartë profesionale. Kursi shkollor i IB-së ofrohet në gjimnazin literaro-real të Ramibyhllit.

Shkolla e mesme profesionale (Fachmittelschule)

Shkolla e mesme profesionale (FMS) çon pas tre viteve, në pesë profilet, në një dëshmi të shkollës së mesme profesionale, e cila mundëson hyrjen në një shkollë më të lartë profesionale. Në vitin e katërt mund të fitohet në të gjithë profilet (shëndetësi dhe shkencë natyrore, pedagogji, komunikacion dhe informacion, muzikë dhe teatër) matura profesionale e cila hap mundësitë për hyrje në drejtime të veçanta studimesh, në një shkollë të lartë profesionale. Në shumicën e profileve, viti i katër përbëhet nga një praktikë e zgjedhur në fushën profesionale dhe në të gjithë profilet, nga një punim i maturës profesionale. Në profilin pedagogjik në vitin e katërt frekuentohet gjatë një semestri një kurs i përgjithshëm arsimor «Matura profesionale pedagogjike» (Fachmaturität Pädagogik) i cili përfundon me një provim dhe siguron studimin në shkollat e larta pedagogjike.

Shkolla e mesme tregtare (Handelsmittelschule) dhe shkolla e mesme e informatikës (Informatikmittelschule)

Në maturën profesionale të tregtisë çojnë shkolla e mesme tregtare (HMS) dhe shkolla e mesme e informatikës (IMS). Shkolla e mesme tregtare përfundon me një certifikatë zvicerane shtesë të aftësisë si tregtare/tregtar kurse shkolla e mesme e informatikës me një certifikatë zvicerane shtesë si informaticiente / informaticient.

Procedura e regjistrimit

- Regjistrimi përfundimtar për gjimnazet FMS dhe HMS është 10 shkurti.
- Për gjimnazin e arteve dhe sportit, regjistrimi i fundit është 15 janari.
- Për shkollën e mesme të informatikës, regjistrimi i fundit është 30 shtatori

Gjimnazet dhe shkollat e mesme tregtare dhe profesionale organizojnë gjithmonë në muajin nëntor (shkolla e mesme e informatikës në fund të gushtit) aktivitete orientuese për prindërit dhe nxënësit e ardhshëm. Të dhënat e sakta në lidhje me këto aktivitete publikohen në gazetën shkollore të shtatorit të kantonit të Cyrihut.

Dokumentet për regjistrim mund të meren në mbrëmjet e aktiviteteve orientuese ose në sekretariatet e shkollave përkatëse (ata mund të porositen edhe nëpërmjet telefonit me një taksë prej Fr. 20.–). Regjistrimi bëhet nga prindërit në rektoratin e gjimnazit përkatës.

Broshurë informuese për shkollat e mesme në kantonin e Cyrihut

Shkollë të mesme po - por cilën?

Adresë përkatëse:

Bildungsdirektion Kanton Zürich
Mittelschul- und Berufsbildungsamt
Ausstellungsstrasse 80, Postfach
8090 Zürich

Faqja e internetit e zyrës- së shkollës së mesme dhe arsimimit profesional përmban informacione të hollësishme aktuale për ciklin e dytë II në kantonin e Cyrihut:

www.mba.zh.ch

Oferta të tjera arsimore (oferta lidhëse)

Të rinjve, të cilët nuk mund të gjejnë vende pune pas shkollës fillore, u qëndrojnë hapur plot mundësi të tjera: Klasa e 10-të, shkolla për gjetjen e profesionit (Berufswahlschule), viti për përgatitje për profesionin (Berufsvorbereitungsjahr).

Informacione mbi këtë mund të gjeni nën:

www.bws.ch

www.mba.zh.ch

Orientues në internet për të rinjtë, familjen dhe profesionin:

www.lotse.zh.ch

Kjo është një faqe informuese e internetit shumë e rekomanduar për prindërit dhe të rinjtë, nëse bëhet fjalë për atë: se si të vazhdohet pas shkollës?

© Februar 2014 | Bildungsdirektion Kanton Zürich | Volksschulamt